

AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT,  
FORMIMIT PROFESIONAL DHE  
KUALIFIKIMEVE

**RAPORTI VJETOR 2017**

# Pasqyra e lëndës

<b>Misioni i AKAFPK-së.....</b>	<b>3</b>
<b>Struktura.....</b>	<b>4</b>
<b>Kontakte .....</b>	<b>5</b>
<b>AKRONIME.....</b>	<b>6</b>
<b>PËRMBLEDHJE .....</b>	<b>7</b>
Veprimtaritë kryesore të AKAFPK-së.....	7
Zbatimi dhe mbyllja e projektit “Skemat e Çirakërisë për Punësimin e të Rinjve në Shqipëri”/Erasmus+ .....	8
Zbatimi i projektit “EPALE National Support Services 2017-2018” /Erasmus+ .....	9
Marrëveshja e Grantit 2017-2300 “National Coordinators for the Implementation of the EU Adult Learning Agenda” .....	10
Zbatimi i programit 24-ditor të trajnimit “Bazat e didaktikës në AFP” .....	10
Problematika.....	10
<b>ANEKSE: VEPRIMTARITË E DETAJUARA SIPAS SEKTORËVE.....</b>	<b>12</b>
<b>ANEKS I Veprimtaria e Sektorit të Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale .....</b>	<b>12</b>
Veprimtari lidhur me Profesionet .....	12
Veprimtari lidhur me Kualifikimet profesionale.....	13
SPKP – Lista e Produkteve 2017 .....	16
<b>ANEKS II VEPRIMTARIA E SEKTORIT TË SKELETKURRIKULAVE DHE STANDARDEVE TË TRAJNIMIT TË MËSUESVE NË AFP (SSTM) .....</b>	<b>18</b>
SSTM – Lista e produkteve për vitin 2017 .....	24
<b>ANEKS III SEKTORI I VLERËSIM-CERTIFIKIMIT TË NXËNËSVE &amp; AKREDITIMIT TË OFRUESVE TË AFP-së .....</b>	<b>25</b>
SVCA – Lista e produkteve 2017.....	30
<b>ANEKS IV SEKTORI I ADMINISTRATËS, FINANCËS DHE TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT .....</b>	<b>32</b>

## MISIONI I AKAFPK-SË

AKAFPK-ja ka objekt kryesor të veprimtarisë së saj krijimin e një sistemi unik të kualifikimeve profesionale, të njohura në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe zbatimin e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

Në përmbushje të misionit të saj, AKAFPK-ja kryen funksionet e mëposhtme:


- Harton dhe rishikon Listën Kombëtare të Profesioneve, Listën Kombëtare të Kualifikimeve profesionale, nivelet dhe standardet përkatëse
- Harton dhe rishikon skelet-kurrikulat e kualifikimeve profesionale;
- Harton dhe rishikon standardet e trajnimit të mësimdhënësve të AFP-së;
- Përcakton parimet dhe kriteret e vlerësimit dhe certifikimit për kualifikimet profesionale;
- Akrediton institucionet e AFP për kualifikimet profesionale;
- Lëshon certifikatat e kualifikimeve profesionale për individët;
- Siguron që standardet e kompetencave të jenë në përputhje të plotë me praktikat më të mira ndërkombëtare, në veçanti me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve dhe Sistemin Evropian të Krediteve për AFP-në;
- Siguron bashkëveprimin e të gjithë aktorëve kontribues të shoqërisë, në të gjitha nivelet dhe fazat e planifikimit, zhvillimit dhe zbatimit të programeve të AFP-së.

## STRUKTURA

Përcaktimi i strukturës dhe organikës së AKAFPK-së është sanksionuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.321, datë 21.4.2011 "PËR KRIJIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE TË ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE KUALIFIKIMEVE".

Struktura e AKAFPK-së ka gjithsej 16 punonjës.

Struktura organizative e saj është si më poshtë:



## **KONTAKTE**

Sonila Limaj

Drejtor i AKAFPK-së Tel: 042237087/11 Fax: 042223795

Email: Sonila.Limaj@akafp.gov.al

Ejvis Gishti

Pergjegjëse e Sektorit të Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale

Tel: 042237087/19

Email: Ejvis.Gishti@akafp.gov.al

Alqi Mustafai

Pergjegjës i Sektorit të Skelet-Kurrikulave dhe Standardeve të Trajnimit të Mësuesve të AFP-së

Tel: 042237087

Email: Alqi.Mustafai@akafp.gov.al

Teuta Braço

Pergjegjëse e Sektorit të Administratës, Financës dhe Teknologjisë së Informacionit

Tel: 042230497/20

Email: Teuta.Braco@akafp.gov.al

## **AKRONIME**

<b>AFP</b>	Arsimi dhe Formimi Profesional
<b>AKAFP</b>	Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
<b>AKP</b>	Agjencia Kombëtare e Provimeve
<b>ETF</b>	European Training Foundation (Fondacioni Evropian i Trajnimeve)
<b>BOTEM</b>	Shtëpia Botuese e Teksteve Mësimore
<b>DRFPP</b>	Drejtori Rajonale e Formimit Profesional Publik
<b>ISCED</b>	International Standard for Classification in Education (Standardi Ndërkombëtar për Klasifikim në Arsim)
<b>ILO</b>	International Labor Organisation (Organizata Ndërkombëtare e Punës)
<b>IZHA</b>	Instituti i Zhvillimit të Arsimit
<b>LKP</b>	Lista Kombëtare e Profesioneve
<b>KEK</b>	Korniza Evropiane e Kualifikimeve
<b>KShK</b>	Korniza Shqiptare e Kualifikimeve
<b>MMSR</b>	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë
<b>PBA</b>	Programi Buxhetor Afatmesëm
<b>SAFTI</b>	Sektori i Administratës, Financës dhe Teknologjisë së Informacionit
<b>SPKP</b>	Sektori i Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale
<b>SSTM</b>	Sektori i Skeletkurrikulave dhe Standardeve të Trajnimit të Mësuesve
<b>SVCA</b>	Sektori i Vlerësim-Certifikimit dhe Akreditimit të Ofruesve të AFP-së

## **PËRMBLEDHJE**

### **Veprimtaritë kryesore të AKAFPK-së**

Në vitin 2017, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve ka zbatuar veprimtaritë në përputhje me planin vjetor të punës të miratuar nga drejtori.

Veprimtaritë e AKAFPK-së janë zhvilluar në përputhje me prioritetet e zhvillimit të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, prioritetet të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014-2020, në objektivat e përcaktuara nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për rritjen e cilësisë në AFP, si dhe në parashikimet e PBA-së.

Në kuadër të analizës vjetore të Ministrisë, të mbajtur në datën 13 janar 2017, drejtorja e AKAFPK-së prezantoi në MMSR arritjet kryesore të vitit 2016 dhe planin vjetor të punës për vitin 2017.

Sipas këtij plani, AKAFPK e fokusoi punën në këto prioritetet kryesore:

- Lista Kombëtare e Profesioneve
- Zhvillimi i analizave të punës dhe hartimi i standardeve të profesioneve
- Zbatimi dhe zhvillimi i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve në sektorin e AFP-së
- Hartimi i përshkrimeve të kualifikimeve për nivelet 2,3 dhe 4 të KShK-së
- Hartimi i skeletkurrikulave për kualifikimet profesionale të niveleve 2, 3 dhe 4 të KShK-së;
- Hartimi i materialeve mësimore mbështetëse për mësues e nxënës të arsimit të mesëm profesional në zbatim të skeletkurrikulave;
- Hartimi i programeve orientuese për provimet e niveleve të arsimit të mesëm profesional si dhe hartimi i programeve orientuese për maturën shtetërore profesionale
- Hartimi i bankave të testeve si instrument mbështetës për mësimdhënësit në hartimin e provimeve të niveleve të arsimit të mesëm profesional
- Sigurimi i cilësisë në AFP.

Në vitin 2017, AKAFPK ka koordinuar me INSTAT-in dhe MMSR-në procesin e miratimit të Listës Kombëtare të Profesioneve të përditësuar nga Këshilli i Ministrave, e cila u miratua me VKM nr. 514, datë 20.09.2017 dhe u botua në fletoren zyrtare.

Sipas planit të punës, gjatë vitit 2017 u krye një analizë profesioni dhe u hartuan katër standarde të profesioneve.

U hartuan 15 përshkrime të kualifikimeve profesionale të niveleve 2, 3 dhe 4 të KShK-së, lista e detajuar e të cilave gjendet në anekset e këtij raporti.

Gjatë vitit 2017 u hartuan e u rishikuan dhe u përcollën në MMSR për miratim gjithsej 17 skeletkurrikula të AFP-së në përputhje me nivelet 2, 3 dhe 4 të KShK-së. Lista e detajuar gjendet në anekset e këtij raporti.

Në mbështetje të procesit mësimor të shkollave të mesme profesionale publike, AKAFPK, gjatë vitit 2017, hartoi gjithsej 18 materiale mësimore, të cilat publikohen vetëm në formë elektronike në faqen e internetit të institucionit. Në procesin e hartimit të materialeve mësimore mbështetëse, AKAFPK përpiqet të koordinojë veprimtarinë e saj me BOTEM, si ent publik përgjegjës për botimin e teksteve shkollore për arsimin profesional. Koordinimi me BOTEM-in është fokusuar në përpilimin e listës së materialeve mësimore për t'u hartuar nga AKAFPK dhe në listën e teksteve shkollore që hartohen nga BOTEM.

Gjatë vitit 2017 janë hartuar e rishikuar gjithsej 14 programe orientuese për provimet e niveleve të arsimit të mesëm profesional dhe 5 programe orientuese të maturës shtetërore. Gjithashtu, janë hartuar edhe 12 banka testesh.

Puna e AKAFPK-së për sigurimin e cilësisë në AFP u fokusua në hartimin dhe konsultimin e Udhëzuesit të vetëvlerësimit dhe përcjelljes së tij në MMSR për miratim.

Gjithashtu, si institucioni qendror përgjegjës për sigurimin e cilësisë në AFP, AKAFPK është angazhuar në Forumin për Sigurimin e Cilësisë në AFP të lançuar nga ETF në nëntor 2017 për një periudhë dyvjeçare.

AKAFPK është angazhuar në Task Forcën e KShK-së për zbatimin e procesit të referencimit me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve (KEK). Me mbështetjen e ETF-së, janë zhvilluar dy ëorkshop-e: “Përfshirja e kualifikimeve në KShK” (janar 2017) dhe “Sigurimi i cilësisë së kualifikimeve në KShK” (maj 2017). AKAFPK, si pjesë e Task Force ka organizuar përmbajtjen e të dy këtyre ëorkshop-eve.

Gjithashtu, në kuadër të veprimtarisë së Task Force së KSHK-së u organizua Konferenca Kombëtare për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve, në të cilën morën pjesë 122 përfaqësues të institucioneve arsimore të të gjitha niveleve: arsimit të mesëm të përgjithshëm, arsimit profesional, formimit profesional dhe të institucioneve të arsimit të lartë. Pjesëmarrësit u njohën me karakteristikat kryesore të KShK-së, si dhe me zhvillimet më të fundit në vendet evropiane dhe në vendin tonë.

Gjithashtu, AKAFPK merr pjesë me një anëtar të nominuar nga qeveria shqiptare në Bordin Këshillimor të KEK.

Përpos veprimtarive të bazuara në funksionet thelbësore të saj, AKAFPK ka zbatuar disa projekte të financuara nga programi Erasmus+ i BE-së, si dhe koordinuar e monitoruar zbatimin e programit 24-ditor të trajnimit “Bazat e didaktikës në AFP” në zbatim të detyrimeve të Marrëveshjes për mbështetjen buxhetore.

### **Zbatimi dhe mbyllja e projektit “Skemat e Çirakërisë për Punësimin e të Rinjve në Shqipëri”/Erasmus+**

Pas riçeljes së fondit buxhetor të dedikuar për këtë projekt, u zhvilluan në periudhën janar-shkurt 2017 trajnimet e instruktorëve në kompani dhe të mësuesve të shkollave të përfshira në



projekt. Sipas planit të projektit u trajnuan 15 mësues të shkollave dhe 15 instruktorë nga bizneset e përfshira në projekt. Në kuadër të këtij projekti u gjetën vende praktike për 106 nxënës të profileve “reception” dhe “kuzhinë” në 23 hotele dhe restorante në Tiranë.

Më 16 mars 2017, AKAFPK dhe HIBB me pjesëmarrjen e të gjithë aktorëve: MMSR, biznese, shkolla, nxënës dhe organizata partnere, organizuan aktivitetin përmbyllës të këtij projekti, në të cilin u prezantuan arritjet kryesore dhe mundësitë e zbatimit të modelit dual bashkëpunues në mënyrë sistematike.

Në periudhën prill-qershor 2017 u përgatitën raportet teknike dhe financiare për donatorin. Në periudhën shtator – tetor 2017, projekti u auditua nga një ekspert kontabël dhe audit i licencuar dhe gjetjet e këtij procesi auditimi iu dërguan Agjencisë Evropiane për Kulturë dhe Media Audiovizive (EACEA) të Komisionit Evropian. Nga ana e AKAFPK-së, ky projekt është përfunduar, por procedurat përfundimtare do të ekzekutohen pas konfirmimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë si institucion epror dhe partner i drejtpërdrejtë për Marrëveshjet e Grantit.

### **Zbatimi i projektit “EPALE National Support Services 2017-2018” /Erasmus+**

Si qendër kombëtare mbështetëse e emëruar nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, AKAFPK ka nënshkruar Marrëveshjen e Grantit nr. 2016-3042 për promovimin e Platformës Elektronike për të Nxënësit e të Rriturve në Evropë (EPALE) në periudhën 2017-2018.

Në zbatim të planit të punës së këtij projekti është organizuar një takim me institucione ofruese, politikëbërëse dhe organizata në fushën e të nxënësve të të rriturve, në datën 19 maj 2017 në Tiranë. Ky takim kombëtar, në të cilin morën pjesë rreth 56 vetë, u ndoq nga dy takime rajonale të zhvilluara në Gjirokastrë dhe në Durrës.

Në Gjirokastrë, aktiviteti u zhvillua në partneritet me Universitetin “Eqerem Çabej” dhe me institucionet ofruese të AFP-së në këtë qytet. Pjesëmarrësit ishin aktivë dhe të interesuar të njiheshin me prioritetet dhe zhvillimet në sektorin e të nxënësve të të rriturve. Për promovimin e Platformës EPALË, AKAFPK i kushton rëndësi të veçantë edhe bashkëpunimit me organizata lokale, të cilat punojnë, në mënyrë të posaçme, me ato grupe shoqërore, të cilat kanë akses të kufizuar në procese mësimore, siç janë zonat e prekura nga migracioni i brendshëm. Ndaj, më 16 qershor 2017, në partneritet me Qendrën Komunitare “Sot për të Ardhmen”, AKAFPK organizoi një takim prezantues në Durrës, në të cilin u përfshinë të gjithë aktorët politikëbërës në nivel qendror (MMSR) dhe lokal (Bashkia Durrës), institucionet ofruese të të nxënësve të të rriturve: Universiteti “Aleksandër Moisiu”, shkollat profesionale dhe Drejtoritë Rajonale të Formimit Profesional Publik të Shkodrës dhe Durrësit, si dhe Drejtoria Lëvizëse e Formimit Profesional, si dhe studentë të shkencave të edukimit nga Universiteti i Durrësit.

Aktivitetet e tjera rajonale u zhvilluan në gjysmën e dytë të vitit në Peshkopi, më 12 tetor 2017 dhe në Korçë më 23 tetor 2018.

Gjithashtu në zbatim të këtij projekti janë publikuar në këtë platformë elektronike, si dhe në rrjetet sociale artikuj, lajme, studime mbi të nxënësve të të rriturve, sipas indikatorëve të përcaktuar nga donatori.

Në kuadër të javës për të nxënit gjatë gjithë jetës, AKAFPK organizoi takime me drejtues të Universitetit Bujqësor të Tiranës dhe Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës dhe në vijim u prezantua Platforma EPALE në këto dy universitete në fillim të muajit dhjetor 2017.

Lidhur me menaxhimin teknik e financiar të këtij projekti, AKAFPK raporton periodikisht Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

### **Marrëveshja e Grantit 2017-2300 “National Coordinators for the Implementation of the EU Adult Learning Agenda”**

Në vijim të emërimit zyrtar nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, AKAFPK iu përgjigj thirrjes së dedikuar (Restricted Call for Proposals) për hartimin e planit kombëtar për të nxënit e të rriturve në Shqipëri dhe dorëzoi këtë aplikim sipas afateve në datën 12 maj 2017. Në vijim të procedurave, në fillim të shtatorit 2017, EACEA njoftoi mbi rezultatet pozitive të këtij aplikimi dhe dërgoi për nënshkrim Marrëveshjen e Grantit nr. 2017-2300, e cila u nënshkrua nga drejtori i AKAFPK-së më 20.11.2017.

### **Zbatimi i programit 24-ditor të trajnimit “Bazat e didaktikës në AFP”**

AKAFPK koordinoi dhe monitoroi zbatimin e programit 24-ditor të trajnimit “Bazat e didaktikës në AFP”, duke krijuar 9 grupe mësuesish/instrukturësh nga 19 shkolla të mesme profesionale publike në Tiranë, Lezhë, Shkodër, Korçë, Vlorë, Berat dhe Fier dhe 6 Drejtori Rajonale të Formimit Profesional publik në Tiranë, Berat, Fier, Korçë dhe Vlorë. Në trajnim janë përfshirë (regjistruar) 297 mësues e instruktorë, nga të cilët janë certifikuar gjatë dhe në fillim të vitit 2018 252 mësues dhe instruktorë.

### **Problematika**

Në vitin 2017, pavarësisht planifikimit bazuar në objektiva të qarta, AKAFPK arriti të realizonte vetëm 40.25% të buxhetit të alokuar në zërin 602 të buxhetit vjetor. Disa nga problemet kryesore për mosrealizimin e buxhetit vjetor të planifikuar janë:

#### *Kuadri ligjor*

Veprimtaria e AKAFPK-së është e lidhur ngushtë me përmirësimin e kuadrit ligjor për arsimin dhe formimin profesional në tërësi. Hartimi i programeve të kurseve afatshkurtra të formimit profesional, të cilat ofrohen nga DRFPP-të në të gjithë vendin, mbetet ende një sfidë për institucionin, pasi për ta realizuar këtë detyrë, kërkohet një akt nënligjor i posaçëm.

Miratimi i një Vendimi të Këshillit të Ministrave dhe i strukturës dhe organikës përkatëse në zbatim të Ligjit nr. 15, datë 16.2.2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” është domosdoshmëri për të garantuar funksionimin e institucionit dhe ushtrimin e funksioneve të reja të parashikuar në ligjin e sipërcituar.

Më tej, miratimi i ndryshimeve në Ligjin nr.10247, datë 4.3.2010 “Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve” dhe miratimi në Këshillin e Ministrave të Listës Kombëtare të Profesioneve të rishikuar, janë thelbësore për vijimësinë e punës së institucionit.

### *Plotësimi i vendeve vakante*

Ushtrimi i funksioneve të institucionit është ndikuar edhe nga procedurat e zgjatura të rekrutimit nëpërmjet Departamentit të Administratës Publike.

Që prej datës 24.1.2016 është i paplotësuar vendi vakant i një specialisti në Sektorin e Skeletkurrikulave dhe Standardeve të Trajnimit të Mësuesve, si dhe prej datës 2 qershor 2017 është i lirë pozicioni i shefit të Sektorit të Vlerësimit, Certifikimit dhe Akredimit të Ofruesve të AFP-së.

### *Infrastruktura*

Pajisjet kompjuterike të institucionit nuk janë rinovuar për një periudhë prej 10 vjetësh, qysh prej vitit 2007, kur AKAFPK ka nisur punën. Të gjithë kompjuterët e punonjësve i Promirëmbajtja e tyre. Projekti i investimeve është përcjellë çdo vit bashkë me Projekt-Buxhetin Afatmesëm (PBA).

## **ANEKSE: VEPRIMTARITË E DETAJUARA SIPAS SEKTORËVE**

### **ANEKS I VEPRIMTARIA E SEKTORIT TË PROFESIONEVE DHE KUALIFIKIMEVE PROFESIONALE**

#### **Veprimtari lidhur me Profesionet**

Sektori i Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale (SPKP) në bashkëpunim të ngushtë me INSTAT dhe Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë ka ndjekur procedurën e miratimit të Listës Kombëtare e Profesioneve (LKP) e rishikuar gjatë vitit 2016. LKP u miratua me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 514, datë 20.9.2017 për “Miratimin e Listës Kombëtare të Profesioneve (LKP), të rishikuar”.

Me mbështetjen e Programit “Zhvillimi i Aftësive për Punësim” (2014-2018), i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe i zbatuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), në vijim të veprimtarisë për publikimin e LKP, është konceptuar struktura përmbajtësore dhe vizuale e publikimit elektronik të LKP në faqen e internetit të AKAFPK, si dhe është garantuar hap pas hapi cilësia e hedhjes së informacionit të LKP-së në portalin LKP. Në vijim, AKAFPK po ndjek procedurën e hostimit në faqen e internetit.

Me mbështetjen e projektit Altour, bazuar në gjetjet e studimit për identifikimin e nevojave për kualifikime profesionale të cilat duhet të popullojnë nivelet e KSHK-së në sektorin e mikpritjes dhe turizmit (2016), janë hartuar standardet për 4 profesione, respektivisht “Punonjës ndihmës në hoteleri turizëm”, “Kamerier dhe banakier”, Punonjës shërbimi në hotel dhe restorant” dhe “Udhërrëfyes turistik”. Procesi i hartimit të standardeve të profesioneve është bërë sipas një metodologjie të zbatuar për këtë qëllim, me pjesëmarrjen e më së shumti të ekspertëve të profesionit në sektorin privat, por edhe me përfaqësues të shkollave profesionale. Ndërkohë janë reflektuar inputet e validimit të tri standardeve të profesioneve (“Punonjës ndihmës në hoteleri turizëm”, “Kamerier dhe banakier”, Punonjës shërbimi në hotel dhe restorant”) nga ekspertët ndërkombëtarë, si dhe është i organizuar dhe realizuar procesi i validimit të jashtëm të standardit të profesionit “Punonjës ndihmës në hoteleri dhe turizëm” nga ekspertët e botës së punës në vend.

Në mbështetje të procesit të zhvillimit të kurrikulës për kurse afatshkurtra, si dhe bazuar në kërkesën për kualifikime për profesionin “Kasap”, është hartuar analiza e profesionit “Kasap” me ekspertët të këtij profesioni nga bizneset.

## **Veprimtari lidhur me Kualifikimet profesionale**

### *II.1. Draft lista kombëtare e kualifikimeve profesionale*

Gjatë këtij viti, janë zhvilluar vizita në shkollat profesionale në Vlorë, Sarandë dhe Gjirokastrë për të grumbulluar mendime për ecurinë e kualifikimeve, si dhe për t'i orientuar ofruesit në zgjedhjen e kualifikimeve nga lista përkatëse sipas tendencave të tregut të punës në rajon.

Me mbështetjen e ETF, është hartuar inventari i kualifikimeve profesionale dhe analiza e kualifikimeve në vend. Inventari i kualifikimeve përfshin 10 tipe kualifikimesh që ofrohen në nivelet 2-8 të KSHK-së. Ky inventar përfshin 363 kualifikime të ofruara në mbi 19 fusha të ndryshme profesionale, dhe siguron informacione të rëndësishme lidhur me aspekte të llojit të kualifikimit, rrugëve të progresit në KSHK, procedurave të sigurimit të cilësisë për futjen e kualifikimeve profesionale në KSHK, aspekte të zhvillimit të standardeve të kualifikimeve profesionale, etj.

### *II.2. Përshkrimet të kualifikimeve profesionale*

Gjatë këtij viti, janë hartuar 15 përshkrime të kualifikimeve profesionale në terma të rezultateve të të nxëniet në njohuri, shprehje profesionale dhe kompetenca të përgjithshme në 14 fusha profesionale, për nivelet 2,3 dhe 4 të KSHK-së. Në këtë proces janë angazhuar mbi 60 bashkëpunëtorë duke përfshirë përfaqësues të bizneseve të ndryshme, por edhe mësues të shkollave profesionale. Lista e detajuar e përshkrimeve të kualifikimeve profesionale është në aneksin II.

Me mbështetjen projektit Al-Tour, të zbatuar nga KulturKontakt, është rishikuar përshkrimi i kualifikimit profesional "Hoteleri-Turizëm", Niveli II në KSHK duke shfrytëzuar plotësisht informacionin e standardit të profesionit "Punonjës ndihmës në hoteleri turizëm".

### *III. Veprimtari në kuadrin e Task Forcës për KSHK dhe anëtarësimit në Grupin Këshillimor të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve (KEK)*

Në kuadrin e veprimtarisë së Task Forcës për KSHK, është kontribuar në të gjitha takimet e zhvilluara gjatë këtij viti, me prezantime, informacione, komente dhe sugjerime për çështje të ndryshme që lidhen me KSHK. Është kontribuar me mendime dhe sugjerime për hartimin e manualit për KSHK dhe broshurës përkatëse të KSHK.

Në muajin mars, Task Forca për KSHK ka organizuar konferencën kombëtare "Korniza Shqiptare e Kualifikimeve" duke pasur si qëllim publikimin dhe promovimin e mëtejshëm të këtij instrumenti të të gjithë aktorët e interesuar në vend. Gjithashtu, me mbështetjen e ETF janë organizuar dy takime 2 ditore në shkurt dhe maj në mbështetje të procesit të referencimit të KSHK me KEK. Në këto takime kanë marrë pjesë përfaqësues të institucioneve të arsimit të niveleve të ndryshme në KSHK, përfaqësues të partnerëve socialë, si edhe donatorët kryesorë për AFP në vend për të harmonizuar përpjekjet e tyre në përputhje me kuadrin institucional dhe ligjor në vend për AFP-në.

Në kuadrin e përfaqësimit në Grupin Këshillimor të KEK është marrë pjesë në katër takime të zhvilluara, ku qëllimi kryesor është procesi referencimit të kornizave kombëtare me atë evropiane për të rritur transparencën në sistemet e kualifikimeve dhe mobilitetin në tregun e punës.

#### *IV. Veprimtari në kuadër të zbatimit të projektit për “Platformën elektronike të të nxënimit të të rriturve” (EPALE)*

Në kuadrin e projektit EPALE, është kontribuar në takimet e organizuara në kuadrin e Projektit EPALE, si dhe në vlerësimin e kandidatëve për ekspertë në kuadrin e projektit. Gjithashtu, është kontribuar me informacione përmbajtjesore (Blog) në platformë për evente të ndryshme në AFP.

#### *V. Bashkëpunim me MMSR dhe institucione të tjera*

Në kuadrin e hartimit të akteve nënligjore në mbështetje të ligjit nr. 15/2017 datë 16.2.2017 për AFP-në, është kontribuar me komente, sugjerime si dhe në hartimin e draft udhëzimit për miratimin e Katalogut Kombëtar të Kualifikimeve Profesionale . Është asistuar në panairin dhe olimpiadën e aftësive të organizuar për promovimin e AFP-së. Gjithashtu, është dhënë kontribut për plotësimin e fishave për raport progresin SKAP 2014-2020.

- Në kuadrin e mbështetjes, për DRFPP-të, janë zhvilluar vizita në qendrat e formimit profesional në Vlorë dhe Gjirokastrë, për hartimin e listës së kurseve unike të formimit profesional.
- Përfaqësues të sektorit kanë marrë pjesë në takime të ndryshme të organizuara nga institucione të ndryshme, të tilla si:
- Pjesëmarrje në 2 takimet e organizuara nga Projekti “Aftësi për Punësim” për gjetjet paraprake të studimit lidhur me “Të nxënimit në vendin e punës”.
- Pjesëmarrje dhe kontribut në takimin e organizuar nga projekti PNUD dhe SHKP për pyetësorin e hartuar për “Analizën e nevojave për formim” 2017.

Pjesëmarrje në takimin “Platforma konsultuese për zhvillim në arsimin profesional - Nevojat për trajnim të mësuesve në TIK”

Pjesëmarrje në takimin e organizuar nga Rrjeti i Agjencive të AFP-së në Evropën Juglindore.

- Pjesëmarrje dhe kontribut në seminarin e organizuar nga projekti AL Tour për “Zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm si një element kyç në Kualifikimin Profesional në Shqipëri”.
- Pjesëmarrje në vizitën studimore të organizuar nga projekti “Aftësi për Punë”, Swisscontact.
- Pjesëmarrje në takimin e Grupit të Përbashkët për Njohjen e Ndërsjellët të Kualifikimeve Profesionale.

#### *VI. Kontribute në kuadrin e zhvillimit të bashkëpunimit me agjenci homologe dhe me projekte të tjera*

Në kuadrin e mbështetjes së EU-IPA, SPKP ka marrë pjesë në rolin e vëzhguesit të procesit të hartimit të 2 standardeve të profesioneve: “Instalues hidraulik të rrjetit të ujësjellës-kanalizimeve” dhe “Teknik të kërkimit, nxjerrjes dhe shfrytëzimit të naftës”.

Me mbështetjen e ETF, është marrë pjesë dhe është kontribuar me prezantime dhe raportime në takimin e ndërkombëtar “Promovimi i kornizave të kualifikimeve”, organizuar në Tiranë.

Gjatë këtij viti, janë organizuar takime të përbashkëta me përfaqësues të Agjencisë Kombëtare për Arsim, Aftësim dhe Arsimin e të rriturve në Kosovë, për krijimin e urave të bashkëpunimit në drejtimin të zhvillimit të të kualifikimeve.

Spektori i Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale ka kontribuar me prezantime në takimin e organizuar në Vjenë, si dhe në takimin e Rrjetit të Agjencive të AFP në vendet e Evropës Jug-Lindore duke pasur si qëllim nxitjen e bashkëpunimit në rajon për të nxënë në vendin e punës.

## **SPKP – Lista e Produkteve 2017**

### *Produkte qw lidhen me profesionet*

1. Lista Kombëtare e Profesioneve e miratuar me Vendim Të Këshillit të Ministrave Nr. 514, datë 20.9.2017 PËR “Miratimin e Listës Kombëtare të Profesioneve (LKP), të rishikuar”
2. Analiza e profesionit “Kasap”
3. Standardi i profesionit “Punonjës ndihmës në hoteleri turizëm”
4. Standardi i profesionit “Kamerier dhe banakier”
5. Standardi i profesionit “Punonjës shërbimi në hotel dhe restorant”.
6. Standardi i profesionit “Udhërrëfyes turistik”

### *Produkte që lidhen me fushën e kualifikimeve profesionale*

#### *I. Inventari i kualifikimeve profesionale*

#### *II. Lista e pwrshkrimeve tw kualifikimeve*

1. “Hoteleri turizëm” niveli II në KSHK, (rishikim)
2. “Mbrojtje mjedisi pyjor”, niveli IV në KSHK,
3. “Teknologji kimike”, niveli II në KSHK, (rishikim)
4. “Tekstil- konfeksion”, niveli II në KSHK (rishikim)
5. “Ekonomi-Biznes”, niveli II në KSHK (rishikim)
6. “Shërbime mjetesh transporti”, niveli II në KSHK (rishikim)
7. “Gjeodezi”, niveli IV, në KSHK (rishikim)
8. “Muratim-suvatim niveli III, në KSHK ”(rishikim),
9. “Veterinari, niveli IV, ”(rishikim)
10. “Detari”, niveli IV në KSHK
11. “Elektroteknikë”, niveli II në KSHK,
12. “Mekanikë”, niveli II në KSHK (rishikim)



13. “Shërbime sociale/shëndetësore” niveli II në KSHK (rishikim)
14. “Teknologji e përpunimit të qumështit”, Niveli III në KSHK (rishikim)
15. “Prodhime druri gjysmë të gatshme”, Niveli i III në KSHK (rishikim)

## **ANEKS II VEPRIMTARIA E SEKTORIT TË SKELETKURRIKULAVE DHE STANDARDEVE TË TRAJNIMIT TË MËSUESVE NË AFP (SSTM)**

Gjatë vitit 2017, veprimtaria e Sektorit të Skeletkurrikulave dhe Standardeve të Trajnimit të Mësuesve të AFP (SSTM) është mbështetur në Planin e punës së AKAFPK, në Planin e punës dhe objektivat e Sektorit, si dhe në objektivat specifike për çdo punonjës të tij. Fokusi i Sektorit ka qënë jo vetëm përmbushja e objektivave për aspektet sasiore të produkteve të planifikuara, por edhe garantimi i cilësisë së proceseve dhe produkteve përkatëse.

Përgjithësisht, Sektori i SSTM i ka përmbushur me sukses objektivat e planifikuara ose të rishikuara sipas situatave dhe mundësive konkrete, pavarësisht nga largimi i një prej specialistëve të sektorit qysh në fillim të viti 2016, i pazëvendësuar edhe gjatë vitit 2017. Kjo edhe si rezultat i të qenit aktiv nga secili antar i sektorit, i punës në grup, i bashkëpunimit me sektorët e tjerë të Agjencisë, me Ministrinë përgjegjëse për AFP, me institucione të tjera, me Shkollat Profesionale dhe DRFPP-të, me partnerët socialë, me donatorët etj. Shkëmbimi i përvojave dhe vullneti për të ngritur në mënyrë të vazhdueshme nivelin profesional të anëtarëve të Sektorit ka ndikuar gjithashtu pozitivisht në përmbushjen e detyrave.

### *Kontributet e Sektorit të SSTM*

Në zbatim të funksioneve të tij, Sektori i SSTM, gjatë vitit 2017, ka kontribuar nëpërmjet kryerjes së një tërësie procesesh dhe realizimit të disa produkteve kryesore që kanë mbështetur zhvillimin e AFP si në nivel qendror, ashtu edhe në nivelin e ofruesve (shkollave profesionale dhe qendrave të formimit profesional).

Më poshtë renditen kontributet kryesore të sektorit, të ndara sipas fushave të veprimtarisë.

#### *1. Hartimi dhe rishikimi i dokumentacionit kurrikular për AFP dhe mbështetja e zbatimit të tij.*

Përgatitja e dokumentacionit kurrikular (skeletkurrikula, programe kursesh të shkurtra, materiale mësimore mbështetëse) përbën vëllimin më të madh të punës së sektorit të SSTM. Moderimi i hartimit të dokumentacionit të ri kurrikular është bërë në përputhje me metodologjinë dhe formatet e miratuara, mbështetur edhe në dokumentet përkatëse të përgatitura nga Sektori i SPKP (përshkrime të profesioneve dhe përshkrime të kualifikimeve). Garanci për cilësinë e tyre ka qënë edhe përvoja e dhjetëra individëve dhe grupeve të punës me specialistë të arsimit dhe formimit profesional, si dhe të biznesit, të përzgjedhur me kujdes nëpërmjet procedurave zyrtare të AKAFPK.

Gjatë vitit 2017, Sektori i SSTM ka moderuar procesin e hartimit të 10 skeletkurrikulave të reja të kualifikimeve profesionale në tre nivele të KSHK.

Në kuadrin e ndryshimeve në kornizën e re kurrikulare të arsimit të mesëm të përgjithshëm, Sektori ka kontribuar në përgatitjen e ndryshimeve në kulturën e përgjithshme të AP, si dhe ka bërë korigjimet e duhura në planin mësimor (për kl.10-11) në të gjitha skeletkurrikulat e kualifikimeve profesionale të nivelit të parë të Arsimit Profesional.

Sektori ka mbikëqyrur ecurinë e zbatimit të skeletkurrikulave që janë në zbatim dhe nisur nga informacionet e marra nga takimet me drejtues, mësues dhe instruktorë të rreth 30 shkollave profesionale, ka drejtuar procesin e *rishikimit dhe përmirësimit të 9 skeletkurrikulave* për vitet shkollore 2017-18 dhe 2018-19.

Për të mbështetur mësuesit e lëndëve profesionale dhe nxënësit në AP, nisur edhe nga fakti që në AP ka mungesa të theksuara të teksteve mësimore, Sektori (në konsultim edhe me BOTEM) ka përcaktuar nevojat më emergjente dhe ka moderuar procesin e hartimit të *18 materialeve mësimore mbështetëse* të lëndëve profesionale.

Përsa i përket *programeve të kurseve të formimit profesional*, Sektori i SSTM qysh në vitin 2016 ka përgatitur dhe ka dërguar për miratim në MMSR, Propozimin “Për një model unik të programeve të kurseve të shkurtra të formimit profesional publik në Shqipëri”, i cili parashtron si formatin, ashtu edhe metodologjinë e hartimit të këtyre programeve, si përgjegjësi e AKAFPK. Në bashkëpunim me Sektorin e SPKP, është hartuar edhe një listë e kurseve të unifikuara të formimit profesional publik. Vonesa në miratimin e Propozimit për kurset e unifikuara dhe e listës përkatëse, si dhe në daljen e Udhëzimit përkatës, e ka penguar Sektorin e SSTM të angazhohet intensivisht në hartimin e programeve të kurseve të shkurtra të formimit profesional. Sidoqoftë, me kërkesë të MMSR, sektori ka moderuar *hartimin programeve për 3 kurse të shkurtra të formimit profesional*.

## *II. Trajnimi dhe udhëzimi i mësuesve dhe drejtuesve në AFP.*

Gjatë vitit 2017, Sektori i SSTM ka mbikëqyrur zbatimin e produkteve kurrikulare në SHP-të dhe DRFPP-të, si dhe ka udhëzuar e këshilluar drejtuesit dhe mësuesit/instruktorët në lidhje me to. Kjo mbështetje është kryer si nëpërmjet kontakteve dhe takimeve të drejtpërdrejta (gjatë takimeve në AKAFPK dhe vizitave në rreth 20 SHP dhe 6 DRFPP), ashtu edhe nëpërmjet komunikimeve në distancë (e-mail, biseda telefonike).

Në kuadër të fillimit të vitit shkollor 2017-18, Sektori kontribuoi në përgatitjen dhe publikimin e një “Udhëzuesi për drejtuesit dhe mësuesit e shkollave profesionale” me informacione mjaft të dobishme për aspektet kurrikulare, të mësimdhënies, të vlerësimit të nxënësve, të organizimit orarit të shkollave të orientimit të tyre nga kërkesat e tregut rajonal të punës.

Përsa i përket mbështetjes së mësimdhënësve të AFP për aspektet didaktike, specialistët e Sektorit, në takimet dhe vëzhgimet e kryera në SHP-të dhe DRFPP-të, kanë marrë të dhëna për gjendjen e mësimdhënësve dhe kanë ofruar mbështetjen e tyre për aspekte të ndryshme didaktike. Sektori ka bërë propozime konkrete për ndryshimet e nevojshme në sistemin e zhvillimit të vazhduar profesional të mësimdhënësve në AFP, duke qenë pjesë aktive, jo vetëm e pilotimit të “njësive të trajnimit” në ofruesit e AFP, por edhe e ndryshimeve ligjore për institucionalizimin e “njësive zhvillimore” në ofruesit e AFP.

Gjatë vitit 2017, Sektori është angazhuar në zbatimin e Programit të Trajnimit 24 ditor për "Bazat e didaktikës në AFP", të mbështetur nga GIZ, KulturKontakt dhe Sills For Jobs. Tre pjestarë të Sektorit kanë kontribuar drejtpërdrejt jo vetëm në koordinimin dhe harmonizimin e zbatimit të këtij programi, por edhe në trajnimin e drejtpërdrejtë të 9 grupeve të mësuesve (rreth 250 pjesmarrës), në rolin e "trajnerëve të mësuesve".

Antarët e Sektorit të SSTM janë angazhuar edhe si trajnerë në moderimin e seancave të trajnimeve për dhjetra mësues dhe instruktorë të shkollave profesionale në drejtimin "Hoteleri-turizëm", si dhe instruktorë të biznesit, të mbështetura nga programi AI - Tour.

Në bashkëpunim me IZHA, Sektori ka mbështetur edhe hartimin e Programit kombëtar të kualifikimit, si përgatitjen e testeve përkatëse për atestimin e mësuesve të AP, për vitin 2017.

### *III. Veprimtari në kuadrin e bashkëpunimeve.*

Një pjesë e ndjeshme e kohës së punës së Sektorit të SSTM i është kushtuar veprimtarive të ndryshme në kuadrin e porosive të Ministrisë përgjegjëse për AFP dhe të bashkëpunimeve me institucione dhe aktorë të tjerë që veprojnë për aspekte të ndryshme të AFP. Të tilla veprimtari janë:

- Pjesmarrje në procesin e rishikimit të kuadrit ligjor të AFP, të draftit të Ligjit të ri të AFP (kryesisht për aspektet e strukturës së arsimit profesional, të funksioneve të AKAFPK dhe të sistemit të kualifikimit të mësimdhënësve), si dhe në hartimin e drafteve të akteve nënligjore përkatëse. Janë dhënë gjithashtu kontribute në hartimin e disa udhëzimeve ose rregulloreve të MMSR/MFE dhe MAS/MASR. Këto kontribute janë dhënë nëpërmjet pjesëmarrjes në grupet e punës përkatëse ose në formën e komenteve me shkrim.
- Në kuadrin e bashkëpunimit të brendshëm të AKAFPK, janë organizuar takime për diskutimin, si dhe janë bërë komente për dokumente të ndryshme të Drejtorisë apo të sektorëve të tjerë të AKAFPK.
- Pjesëmarrje në Komisionin e përzgjedhjes së anëtarëve të grupeve të punës për produktet e AKAFPK dhe në Komisionin e transferimit të nxënësve në AP.
- Përgatitja e planit të buxhetit të Sektorit SSTM si dhe ndryshimet eventuale gjatë vitit.
- Takime në AKAFPK lidhje me formatin e ri të regjistrave dhe amzave për AP.
- Diskutime në lidhje me ndryshimin e formatit të Programeve orientuese për provimet përfundimtare.
- Pjesëmarrje në veprimtaritë në kuadrin e 10 vjetorit të AKAFPK
- Pjesëmarrje në Komisionin për vlerësimin e ofertave për pajisjen e shkollave profesionale me laboratorë didaktikë (kërkesë e MMSR, me financim të BE)
- Komente dhe plotësime në Rregulloren dhe Udhëzimin për Maturën Shtetërore Profesionale, 2017-18.
- Pjesëmarrje si hartues teshtesh, monitorues dhe korrigjues në Provimet e Maturës Shtetërore.
- Komente për Urdhërin për fillimin e vitit shkollor 2017-18 (kërkesë nga MASR)
- Komente për Programin e Atestimit të mësuesve të AP për 2017 (përgatitur nga IZHA)
- Takime në MMSR për Raportin e Progresit të "Strategjisë për Punësim dhe Aftësi", për vitin 2016.

- Takime në MMSR dhe MAS për programin e bashkëpunimit me Shoqatën e personave që nuk dëgjojnë.

#### *IV. Veprimtari në kuadrin e angazhimit në Projekte të AKAFPK.*

Sektori i SSTM është angazhuar në Projektet e AKAFPK, posaçërisht në Projektin “Skemat e çirakërisë për punësimin e të rinjve në Shqipëri” (financuar nga ERASMUS+), deri në mbylljen e këtij projekti, si dhe Projektin “EPALE”.

Në lidhje me Projektin e financuar nga **ERASMUS+**, më hollësisht, veprimtaritë në të cilat është angazhuar Sektori janë:

- Kontribute për përgatitjen e Termave të Referencës për konsulencat dhe në Komisionet e prokurimit të konsulencës dhe blerjeve.
- Kontribute në planifikimin dhe organizimin e veprimtarive të Projektit.
- Përgatitja e dokumentacionit dhe kryerja e prokurimeve publike për blerjen e shërbimit katering për trajnim të instruktorëve të AP dhe instruktorëve të biznesit.
- Kontribute në Trajnimin didaktik për mësuesit dhe instruktorët e shkollave dhe në Trajnimin për Instruktorët e biznesit.

Në lidhje me Projektin **EPALE**, më hollësisht, veprimtaritë në të cilat është angazhuar Sektori janë:

- Takime, diskutime dhe konsultime të vazhdueshme për veprimtaritë e EPALE me ekspertin e të nxëniet për të rritur, për organizimin e javës së të nxëniet gjatë gjithë jetës.
- Kontribute në hartimin e pjesës teknike të raportit përfundimtar të EPALE (Faza I).
- Pjesëmarrje në aktivitetin “Mëso ndryshe - metodat e reja të të nxëniet” organizuar projekti S4J-Tiranë, si dhe përgatitja e informacionit përkatës (EPALE).
- Ndjekja e Webinar-it “Si të realizosh një fushatë editoriale” (EPALE – CSS).
- Kontribute në organizimin e kick-off-it të projektit EPALE NSS 2017-2018.
- Pjesëmarrje dhe kontribute në takimin prezantues të projektit EPALE dhe të strategjisë së komunikimit për periudhën 2017-2018.
- Kontribute në organizimin dhe realizimin e takimeve rajonale për projektin EPALE NSS 2017-2018 në Gjirokastrë, Tiranë dhe Durrës.

Sektori i SSTM ka dhënë kontribut aktiv edhe në veprimtari të tjera bashkëpunimi, si më poshtë:

- Pjesëmarrje në kick-off të programit “Skills for Jobs-S4J”
- Takime me përfaqësues të S4J, ACER dhe të Kkontakt, për organizimin e Trajnimit për “Bazat e didaktikës në AFP”
- Plotësimi i formularit të OECD
- Pjesëmarrje dhe kontribute në takimet për Referencimin e KSHK në KEK
- Kontribute në Workshopin për përhapjen e përvojës së pilotimit të “Njësisë së Trajnimit” (AKAFPK - ETF)
- Pjesëmarrje në takimin për prezantimin e Programit të IPA-s për AFP.

- Plotësimi i Raportit për Indikatorët e IPA për 2016
- Pjesmarrje në takim për prezantimin e Programit “AFP nëpërmjet inovacionit”, në Lushnje (Kooperacioni Italian).
- Pjesmarrje në takim për prezantimin e Programit që zbatohet në Shkollën e Ndërtimit-Tiranë me mbështetjen e donatorëve italianë.
- Takime dhe kontribute në lidhje me studimin për “Work based learning”, mbështetur nga UNDP.
- Pjesmarrje në një workshop për Praktikën në Biznes, organizuar nga “Skills for Jobs-S4J” në Lezhë.
- Pjesmarrje dhe kontribute (prezantime, moderime) në një workshop për “AFP me Cilësi të Lartë për Zhvillimin e Turizmit”, organizuar nga “Al-Tour” në Tiranë.
- Takime me përfaqësues të S4J, Al-Tour (Kkontakt), GIZ për planifikimin dhe organizimin e Trajnimeve për “Bazat e didaktikës në AFP”.
- Pjesmarrje dhe kontribute në seminarin për trajnimin e mësuesve/drejtuesve të hotelierit-turizmit për zbatimin e skeletkurrikulit të ri, në kuadrin e programit të mbështetur nga Al-Tour.
- Pjesmarrje në takim për certifikimin e mësuesve dhe instruktorëve të trajnuar në për “Bazat e didaktikës në AFP”, në Korçë (Al-Tour)

*V. Veprimtari në kuadrin e bashkëpunimit me donatorët dhe institucionet ndërkombëtare, si dhe në veprimtari kombëtare/ndërkombëtare për AFP.*

Sektori i SSTM është angazhuar dhe ka dhënë kontribute në shumë veprimtari të kryera në bashkëpunim me projektet e donatorëve dhe institucionet e ndryshme ndërkombëtare që janë partnerë të rëndësishëm në zhvillimin e AFP në Shqipëri. Më poshtë renditen veprimtaritë kryesore që lidhen me këtë bashkëpunim:

- Pjesmarrje në Workshopin e organizuar nga ETF për Aktet nënligjore të Ligjit të AFP (Udhëzimi për ofruesit e AFP)
- Pjesmarrje në Aktivitetin për “E- Platform in Work Based Learning” në Vjenë, Austri
- Pjesmarrje dhe kontribute në Panairin e Arsimit Profesional (City Park, Tiranë).
- Pjesmarrje në Panairin e Arsimit “Didacta”, në Shtutgart të Gjermanisë.
- Pjesmarrje në Takimin për Indikatorët e SBA, në Torino, Itali.
- Pjesmarrje dhe kontribute në Takimin “Krijimi i platformës rajonale për të mësuar përmes punës në Europën Juglindore”, (ERISEE), Mali i Zi.
- Pjesëmarrje dhe kontribute në takim të EPALË NSSs, Zagreb, Kroaci.
- Pjesmarrje në takim për shkëmbim përvojë me Agjencionin për Arsim, Aftësim Profesional dhe Arsimim të të Rriturve, të Kosovës.

*VI. Veprimtari të tjera.*

Sektori i SSTM gjatë vitit 2017 ka kryer edhe veprimtari të tjera që lidhen me:

- Përgatitjen e dokumentacionit zyrtar që ka të bëjë me veprimtarinë dhe produktet e Sektorit (raporte mujore dhe vjetore, plane mujore dhe vjetore, listë-prezenca të stafit, shkresa të ndryshme, njoftime për bashkëpunëtorët, përzgjedhja e bashkëpunëtorëve, kontratat për bashkëpunëtorët, dokumentacioni për pagesat e bashkëpunëtorëve, planifikimi i buxhetit të sektorit, dokumentacioni financiar, vlerësimi i stafit, materialet për publikime në faqe interneti etj.).
- Pjesëmarrjen në komisionin e AKAFPK për prokurimet e blerjeve.
- Kontribute në rifreskimin me informacione të faqes së internetit të AKAFPK.
- Trajnimin e vazhdueshëm të stafit të Sektorit të SSTM. Kjo është kryer nëpërmjet studimit individual, shkëmbimit të përvojës, pjesëmarrjes në vizita studimore dhe në veprimtari trajnimi, ndjekjes së kualifikimeve formale etj.

## **SSTM – Lista e produkteve për vitin 2017**

### **I. Skeletkurrikula të reja:**

1. “Peshkim” Niveli II (i drejtimit “Detari”).
2. “Peshkim”, Niveli III (i drejtimit “Peshkim”).
3. “Teknologji e përpunimit të plastikës dhe gomës”, Niveli II.
4. “Agroturizëm” Niveli II.
5. “Mbrojtje e mjedisit pyjor”, Niveli III.
6. “Markshejderi”, Niveli II.
7. “Animim social”, Niveli II.
8. “Shpim i puseve të naftës, gazit dhe ujit”, Niveli II.

### **II. Skeletkurrikula të rishikuara:**

1. “Shërbime bankare”, Niveli III.
2. “Silvikulturë”, Niveli III.
3. “Gjeologji miniera”, Niveli I.
4. “Mekanikë bujqësore” Niveli II.
5. “Tekstil konfeksione”, Niveli I
6. “Hoteleri turizëm”, Niveli I
7. “Bujqësi”, Niveli I.
8. “Ekonomi biznes”, Niveli I.
9. “Gjeodezi”, Niveli III

### **III. Materiale mësimore mbështetëse për lëndët profesionale:**

1. “Tregti”, kl.13 (128 orë), të profilit “Tregti”, Niveli III.
2. “Teknikë ndërtimi”, kl.11 (136 orë), të drejtimit “Ndërtim”, Niveli I.
3. “Sigurime”, kl.13, (160 orë), të profilit “Sigurime”, Niveli III.
4. “Teknologjia mekanike”, kl.10 (108 orë), të drejtimit “Mekanikë”, Niveli I.
5. “Teknikë ndërtimi me elemente projekti”, kl.13, (68 orë), të drejtimit “Ndërtim”, Niveli III.
6. “Teknologji e përpunimit të naftës”, kl.12 (68 orë), të profilit “Teknologji e përpunimit të naftës”, Niveli III.
7. “Teknologjia e përpunimit të qumështit”, kl.12 (170 orë), të profilit “Teknologjia e përpunimit të qumështit”, Niveli II.
8. “Detale makinash”, kl.13 (102 orë), të drejtimit “Mekanikë”, Niveli III.
9. “Kontabilitet dhe ligjshmëri bujqësore”, kl.13, (68 orë), të drejtimit “Bujqësi”, Niveli III.
10. “Bimët e arave”, kl.10, (72 orë), të drejtimit “Bujqësi”, Niveli I.
11. “Drejtim fermash bujqësore”, kl.13, (34 orë), të drejtimit “Bujqësi”, Niveli III.
12. “Kontabiliteti bankar”, kl.13 (96 orë), të profilit “Shërbime bankare”, Niveli III.



13. "Organizimi strukturave hoteliere dhe gastronomike", kl.10 (108 orë), të drejtimit "Hoteleri turizëm", Niveli I.
14. "Kontroll tekniko-kimik në teknologjinë ushqimore", kl.13, (128 orë), të drejtimit "Teknologji ushqimore", Niveli III.
15. "Ligjshmëria dhe organizimi në ndërtim", kl.13 (34 orë), të drejtimit "Ndërtim", Niv. III
16. Për lëndën profesionale "Shtrim i rrugëve dhe trotuareve", kl.12, (34 orë), të profilit "Shtrim dhe veshje me pllaka", Niveli II.
17. "Silvoteknika", kl.12, (72 orë), të profilit "Silvikulturë", Niveli III.
18. "Rezistencë materialesh", kl.12 (68 orë), në profilet e nivelit II të drejtimit "Mekanikë".

#### **IV. Programe të kurseve të shkurtra të formimit profesional:**

1. "Përpunim peshku".
2. "Kasap".
3. "Administrim ndërtesash".

#### **V. Programe lëndore**

1. Rishikimi i programit sistetik të lëndës "Bazat e sipërmarrjes", kl.12-13

#### **VI. Udhëzues:**

1. Udhëzues për drejtuesit dhe mësuesit e shkollave profesionale (në kuadrin e fillimit të vitit shkollor 2017-18).

### **ANEKS III SEKTORI I VLERËSIM-CERTIFIKIMIT TË NXËNËSVE & AKREDITIMIT TË OFRUESVE TË AFP-SË**

Gjatw vitit 2017, Sektori i Vlerësim-certifikimit të nxënësve dhe Akreditimit të ofruesve të AFP-së (SVCA), për realizimin e veprimtarive të planifikuara, është mbështetur në objektivat vjetore të kësaj njësie organizative, si dhe në objektivat specifike për çdo punonjës të tij. Sektori është fokusuar në dy drejtime kryesore: a) zhvillimi i kriterëve dhe standardeve të vlerësimit të nxënësve ; b) sigurimi i Cilësisë

## *Veprimtari për zhvillimin e kriterëve dhe standardeve të vlerësimit dhe certifikimit të nxënësve/kursantëve*

### *Hartimi dhe rishikimi i programeve orientuese të niveleve*

Në kuadër të planit vjetor të punës, gjatë vitit 2017 Sektori hartoi dhe rishikoi 14 programe orientuese për provimet përfundimtare të niveleve. U rishikuan ato programe orientuese të cilat kishin ndryshime në skeletkurrikulin përkatës. Gjithashtu, në kuadër të rishikimit dhe hartimit të programeve të reja gjatë këtij viti, u hartua një model i ri formati për programet orientuese. Ky model, pas diskutimeve me shefat e sektoreve dhe pas miratimit nga ana e tyre, u aplikua në programet e reja të niveleve dhe të Maturës.

Për hartimin e programeve të reja sektori mblodhi informacion nga shkollat profesionale, për drejtimet/profilet e reja që ofrohen nga ato, për identifikimin e nevojave përkatëse. Kështu, nga verifikimi i ofertës për vitin shkollor 2017-2018 rezultoi nevoja e hartimit të 10 programeve të reja orientuese për provimet përfundimtare të niveleve duke tejkaluar parashikimin (4 programe orientuese të reja) në planin vjetor. Ndërkohë, për hartimin e programeve të reja orientuese të dy drejtimeve/profileve pilot të GIZ (“Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” dhe “Rrjete të dhënash”) u përshtat formati i ri i programit, në përputhje me strukturën dhe përmbajtjen e re të kurrikulave për këto dy drejtime/profile të reja. Një këtë kuadër nga sektori u realizua një data-bazë për të gjithë nxënësit, në të gjitha drejtimet/profilet, të cilët ndjekin arsimin profesional gjatë vitit 2017-2018.

### *Hartimi dhe rishikimi i programeve orientuese të Maturës Shtetërore Profesionale*

U hartuan 5 programe të reja për Maturën Shtetërore Profesionale, si dhe u plotësuan 28 programe orientuese të Maturës me referencat e bazës ligjore (Udhëzuesi i përbashkët MAS-MMSR dhe Rregullorja e Maturës Shtetërore 2017).

### *Banka testesh*

Një nga veprimtaritë e sektorit, në mbështetje të shkollave profesionale për ofrimin e kualifikimeve profesionale cilësore, është përgatitja e bankave me njësi testi (instrumente vlerësimi) për provimet përfundimtare, por edhe për vlerësimin e vazhduar të nxënësve. Për vitin 2017 ishte planifikuar hartimi i 3400 njësive të testit (21 banka testesh), por për shkak të ndërprejve të herë pas herëshme të fondeve të buxhetit, u monitorua procesi i hartimit i vetëm 12 bankave me njësi testi (në total 2400 njesi testi). Shkollat janë orientuar t’i përdorin këto instrumente si gjatë vitit shkollor, ashtu edhe për hartimin e testeve të provimeve përfundimtare. Nga vizitat e kryera nëpër shkolla në qytetet Tiranë, Vlorë, Gjirokastrë, dhe Sarandë për monitorimin e përdorimit të këtyre bankave rezultoi, se të gjitha shkollat i gjejnë një ndihmesë

mjaft të vlefshme dhe i përdorin ato në vazhdimësi. Madje kanë kërkuar plotësimin edhe të drejtimeve/profileve të mbetura me njësi testi.

### *Certifikimi*

Në fillim të vitit 2017 sektori, në bashkëpunim me Drejtorinë AFP-së pranë MMSR-së, rishikoi të gjitha dokumentet e certifikimit sipas niveleve. Njëkohësisht, sektori hartoi dhe rishikoi listat e kompetencave profesionale (që pasqyrohen në certifikatat e niveleve) për 17 drejtime e profile mësimore.

### *Njehsim programesh studimi*

Në bazë të Udhëzimit nr. 21, datë 09.07.2015 të MMSR dhe MAS, si dhe Rregullores përkatëse të AKAFPK-së një anëtar i Sektorit ka marrë pjesë në kryerjen e procedurave të transferimit të nxënësve, që kanë kryer arsim profesional jashtë vendit. Procedurat kanë të bëjnë me shqyrtimin e dokumentacionit të aplikimit për transferim, njehsimin e lëndëve të kryera, identifikimin e lëndëve të munguara, konvertimin e rezultateve të vlerësimit dhe paraqitjen para komisionit përkatës të AKAFPK-së për miratim.

### *Sigurimi i Cilësisë*

Në kuadër të Programit “Zhvillimi i Aftësive për Punësim” të UNDP-së dhe me mbështetjen e MMSR dhe AKAFPK janë realizuar këto veprimtari:

- Shqyrtimi i komenteve dhe sugjerimeve të përgjegjësve të sektorëve SPKP dhe SSTM dhe reflektimi tek dokumenti Metodologjia e Vetëvlerësimit të IoAFP-së.
- Finalizimi dhe redaktimi i draftit të Metodologjisë së Vetëvlerësimit të IoAFP-së.
- Testimi i template-it online të indikatorëve të cilësisë se EQAVET, për të verifikuar qartësinë dhe lehtësinë e përdorimit të tyre gjatë mbledhjes së informacionit përkatës që do të kërkohet nga ETF.
- Takime konsultative për Vlerësimin, përdorimin dhe hartimin e Testeve të provimeve pëfundimtare të niveleve në shkollat e AFP.

### *Referencimi me Kornizën Europiane të Kualifikimeve*

Me mbështetjen e ETF-së për procesin e referencimit të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK) me Kornizën Europiane të Kualifikimeve (KEK), një përfaqësues i sektorit ka marrë pjesë në Seminarin e 2-të për referencimin me KEK dhe në takimin e Donatorëve.

### *Veprimtari në kuadër të bashkëpunimeve*

Në kuadër të bashkëpunimit me MMSR, janë kryer këto veprimtari:

- Pjesëmarrje në aktivitetin: Cilësia në AFP vizioni ynë, organizuar nga MMSR dhe Ambasada Italiane në shkollën Mekanike, Lushnje
- Në kuadër të bashkëpunimit dhe forcimit të lidhjeve me partnerët socialë, ashtu si në vitet e kaluara, Sektori i SVCA dha kontributin e tij në procesin e bashkëpunimit me qendrën tregtare City Park, për organizimin, përgatitjen e detyrave vlerësuese dhe mbarëvajtjen e Olimpiadës së Aftësive Profesionale 2017, si dhe monitorimin e konkurrimit dhe pjesëmarrjen në grupet e vlerësimit.

### *Në kuadër të bashkëpunimit me MAS, janë kryer këto veprimtari:*

- Dhënia e kontributeve për hartimin e draftit të Rregullores së Maturës Shtetërore 2017 dhe 2018.
- Përgatitja e informacionit të kërkuar nga AKP për tri planet mësimore të reja të drejtimeve/profileve:
  - Zhvillim Website
  - Sigurime
  - Teknologji kimiketë ofruara nga shkollat profesionale publike dhe jopublike, informacion ky që shërben për platformën “Maturanti.”
- Mbështetja e Agjencisë Kombëtare të Provimeve në koordinimin e grupeve të punës për hartimin e testeve të teorisë profesionale të Maturës 2017, për drejtimet/profilet e reja.
- Në bashkëpunim me AKP-në, ndjekja e problematikës me nxënësit maturantë të shkollave profesionale, plotësimin e rubrikave të Certifikatës së Maturës Shtetërore Profesionale tek platforma “Maturanti.”
- Mbështetja dhe konsultimi i vazhdueshëm për problematikën e provimeve të Maturës Shtetërore 2017 dhe të dhënave të portalit “Maturanti”.

### *Në kuadër të projektit EPAL, janë kryer këto veprimtari:*

- Pjesëmarrje në komisionin e vlerësimit të aplikimeve për bashkëpunëtorë të projektit EPAL.
- Pjesëmarrje në komisionin e vlerësimit të ofertave për blerjet (Prokurimet Publike) në mbështetje të aktiviteteve për të Nxënëit e të Rriturve.

### *Veprimtari në kuadër të projektit të GiZ:*

- Monitorim në trajnimin 24-ditor “Bazat e didaktikës në Arsimin Profesional” i cili do të mbështet dhe trajnon të gjithë mësuesit dhe instruktorët e Arsimin dhe Formimit Profesional.

- Gjithashtu, është ngritur dhe nja databazë për të gjithë mësuesit/intruktorët që janë trajnuar dhe po trajnohen në trajnimin 24-ditor.

*Veprimtari në kuadër të projektit SHUKALB:*

Shqyrtimi i dokumenteve më të fundit në suport të programit të trajnimit dhe certifikimit, bazuar në testim për sektorin Ujësjellës Kanalizime për dhënien e komenteve përkatëse.

*Përgatitja e termave të referencës për bashkëpunëtorët e jashtëm*

Pjesë e punës së sektorit është edhe përgatitja e termave të referencës për bashkëpunëtorët e jashtëm:

- Ndjekja e procedurave për njoftimet për bashkëpunëtorë, për hartimin apo rishikimin e 21 programeve orientuese, si dhe hartimin e 6 bankave të testeve për provimet përfundimtare.
- Përgatitja e kontratave të shërbimit, për bashkëpunëtorët e SVCA-së që shpallen fitues.
- Ndjekja e procedurave për pagesën e bashkëpunëtorëve.

## **SVCA – Lista e produkteve 2017**

### *Programe orientuese të rishikuara, Niveli I:*

1. Hoteleri-Turizëm
2. Teknologji ushqimore
3. Pyje

### *Programe orientuese të rishikuara, Niveli II:*

1. Teknologji e përpunimit të brumërave

### *Programe të reja orientuese të niveleve:*

#### • **Niveli I**

1. Kërkim, shpim dhe shfrytëzim nafte, gazi dhe uji
2. Teknologji Informacioni dhe Komunikimi (pilot-GIZ)

#### • **Niveli II**

1. Mekatronikë
2. Peshkim (Detari)

#### • **Niveli III**

1. Zhvillim website
2. Sigurime
3. Gjeologji miniera
4. Peshkim
5. Tregti
6. Rrjete të dhënash (pilot-GIZ)

### *Programe të reja të Maturës Shtetërore Profesionale:*

1. Zhvillim website
2. Sigurime
3. Inxhinieri informatike softwaresh
4. Gjeologji miniera
5. Peshkim
6. Tregti
7. Rrjete të dhënash (pilot-GIZ)

### *Banka testesh:*

1. Prodhime druri gjysëm të gatshme”, Niveli II
2. “Mirëmbajtje dhe riparime mekanike”, Niveli II
3. “Llogari”, Niveli III

4. “Rrjete të dhënash”, Niveli III
5. “Mbështetje e përdoruesve të TIK”, Niveli III
6. “Veterinari”, Niveli III

*Lista të kompetencave profesionale të reja/rishikuara për drejtime/profile:*

Të rishikuara

1. Ndërtim, Niveli I
2. Bujqësi, Niveli I
3. Pyje, Niveli I
4. Teknologji Informacioni dhe Komunikimi (TIK), Niveli I

Të reja

1. Detari
2. Konfeksione (pilot NABER-ADA), Niveli I
3. Teknologji kimike, Niveli I
4. Guidë turistike, Niveli II
5. Reception (pilot ERASMUS+), Niveli II
6. Kuzhinë-Pasticeri (pilot ERASMUS+), Niveli II
7. Mekatronikë, Niveli II
8. Peshkim, Niveli II
9. Miniera, Niveli II
10. Teknologji e përpunimit të mishit e peshkut, Niveli II
11. Teknologji kimike, Niveli III
12. Teknologji Informacioni dhe Komunikimi (TIK) - pilot GIZ, Niveli III
13. Sigurime, Niveli III

Udhëzues

- Udhëzues për vetëvlerësimin e Institucioneve ofruese të AFP-së.
- Udhëzues për drejtuesit dhe mësuesit e shkollave profesionale (në kuadrin e fillimit të vitit shkollor 2017-18) – rubrika për vlerësimin e nxënësve.
- Kontribute për hartimin e Udhëzimit të Maturës Shtetërore (MAS-MFE) 2017 - 2018 për reflektimin e specifikave të maturantëve të shkollave profesionale.

Të tjera

- Hartimi i formatit dhe kritereve të reja të programeve orientuese për provimet përfundimtare të niveleve të arsimit profesional dhe të Maturës Shtetërore Profesionale.
- Përshtatja e formatit të programeve orientues për profilin “Rrjete të dhënash”, Pilot-GIZ dhe të drejtimit mësimor “Inxhinieri informatike sofwaresh”.
- Plotësimi i 28 programeve të Maturës Shtetërore Profesionale me elementet e bazës ligjore për Maturën 2017 (referencat me Udhëzimin dhe Rregulloren përkatëse).

## **ANEKS IV SEKTORI I ADMINISTRATËS, FINANCËS DHE TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT**

**Sektori i Administratës, Financës dhe Teknologjisë së Informacionit** në bashkëpunim me sektorët e tjerë ka realizuar objektivat sektoriale në përputhje me planin e aktiviteteve të institucionit për vitin 2017 si edhe detyra të tjera të paparashikuara për shkak të ndryshimeve në legjislacion, projekteve të fituara nga AKAFPK etj..

1. Reforma e administratës publike dhe zbatimi i legjislacionit të ri për shërbimin civil është një nga përparësitë dhe sfidat kryesore për anëtarësimin e plotë të Shqipërisë në BE. Departamenti i Administratës Publike (DAP), si institucioni publik, qendror, përgjegjës për menaxhimin, mbikëqyrjen e shërbimit civil në të gjitha institucionet e administratës qendrore ka hartuar regjistrin elektronik HRMIS (Human Resources Management Information System), sistemin e menaxhimit të regjistrit të punonjësve të Administratës Publike. Sistemi lehtëson punën e përditshme duke ofruar dixhitalizimin e të dhënave të punonjësve. Në përputhje me udhëzimet periodike të Departamentit të Administratës Publike nëpunësi i AKAFPK-së, që merret me burimet njerëzore ka vazhduar punën me plotësimin e regjistrit HRMIS me të dhënat kryesore të punonjësve të AKAFPK-së.
2. Në bazë të ligjit nr. Nr.9154, datë 06.11.2003 “PËR ARKIVAT”, Rregullores mbi “Normat tekniko–profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë” duke qenë se në organikën e AKAFPK-së nuk ka punonjës me detyrën e arkivit dhe protokollit, 2 nga punonjësit e sektorit të AF&TI krahas detyrave funksionale të tyre kryejnë protokollimin dhe arshivimin e dokumentacionit zyrtar. Lidhur me sa më sipër janë klasifikuar dokumentet e vitit 2017 dhe të vitit 2007 të AKAFPK-së për të vazhduar më pas me inventarizimin e tyre dhe përgatitjen për dorëzim në qershor 2018, pranë Arkivës së Përgjithshme të Shtetit, si detyrim ligjor i AKAFPK-së.
3. Ky sektor, krahas punës periodike në administrimin e dokumentacionit zyrtar elektronik e fizik të AKAFPK-së, në përputhje me procedurat administrative të Institucionit si edhe legjislacionit aktual, ka kontribuar në hartimin e programit të transparencës së AKAFPK-së si edhe rifreskimin e vazhdueshëm të tij. Programi i transparencës përcakton kornizën e veprimtarisë së Agjencisë në kuadër të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” dhe është i pasqyruara në faqen zyrtare elektronike të AKAFPK-së, në adresën: <http://www.akafp.gov.al/rreth-nesh/programi>.
4. AKAFPK, në përputhje me objektivat dhe misionin ligjor të saj, në zbatim të Udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 21, datë 9.7.2015 “Për procedurat e transferimit të nxënësve nga një nivel/drejtimit i arsimit profesional në gjimnaz, në zbatim të “Rregullores së brendshme të AKAFPK-së për procedurat e transferimit të nxënësve shqiptarë ose të huaj, të cilët transferojnë studimet nga shkollat profesionale jashtë shtetit në shkollat profesionale në Shqipëri - procedura e njëvlershmërisë së studimeve të kryera” ka kryer njehsimin e programeve të ndjekura nga nxënësit shqiptarë ose të huaj që kanë shprehur kërkesat për transferimin e studimeve të tyre nga shkollat profesionale jashtë shtetit në shkollat




profesionale në Shqipëri. Komisioni ka shqyrtuar rastet e paraqitura pranë AKAFPK-së, të cilëve u janë kthyer përgjigjet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

5. AKAFPK përfaqësohet nga faqja elektronike zyrtare me adresë: [www.akafp.gov.al](http://www.akafp.gov.al). Në këtë faqe janë pasqyruar veprimtaritë kryesore të institucionit si edhe produktet e realizuara prej stafit të tij në fushën e arsimit dhe formimit profesional. Nëpërmjet këtij website lehtësisht të aksesueshëm, të interesuarit mund të informohen rreth punës së përditshme të AKAFPK-së, legjislacionit shqiptar në fushën e AFP. Kjo faqe është aktive dhe përditësohet me veprimtari e njoftime të ndryshimet për t'i ardhur në ndihmë bashkëpunëtorëve shqiptarë apo të huaj, të interesuar në realizimin e produkteve në fushën e AFP. Në rritje të transparencës, është publikuar, gjithashtu, mënyra e funksionimit të institucionit, mënyra e financimit të tij, e organizimit, struktura, adresa e institucionit, numrat e kontaktit si dhe adresa elektronike. Gjithashtu, në këtë faqe elektronike pasqyrohen veprimtaritë e projekteve të AKAFPK-së në kuadër të Programit “ERASMUS +. Sektori i AF&TI, veç rolit kryesor në përditësimin e website të AKAFPK-së, ka administruar dhe mirëmbajtur rrjetin kompjuterik të institucionit.
6. Në kuadër të projekti “Skemat e Çirakërisë për Punësimin e të Rinjve në Shqipëri”, projekt i Programit “ERASMUS +”, për Arsimin, Trajnimin, Rininë dhe Sportin, sektori jonë ka kontribuar në mbështetjen e auditimit permbylles të projektit duke i vwnw nw dispozicion dokumentacionin financiar dhe administrativ.
7. AKAFPK-ja është njësia koordinuese dhe përgjegjëse për zbatimin e Platformës Evropiane për Arsimin e të Rriturve (EPALE). Në kuadër të kësaj platforme AKAFPK ka zbatuar projektin EPALE NSS in Albania. Në këtë projekt, sektori i AF&TI ka dhënë kontributin e anëtarëve të tij në zbatim të objektivave të projektit dhe në përputhje me marrëveshjen e tij. Projekti do të shtrihet edhe për periudhën 2017- 2018. Veç kësaj, sektori ka kontribuar në hartimin e disa dokumenteve të nevojshme për në MMSR dhe Ministrinë e Financave (MF).
8. Për vitin buxhetor 2017, AKAFPK filloi aktivitetet e saj në janar 2017 me një buxhet të përgjithshëm prej 36,500,000 lekë. Nga këto për zërin 602 AKAFPK kishte të miratuara në janar 2017, shumën 19,000,000 lekë dhe më pas të konfirmuara nga MMSR dhe dega e Thesarit të Shtetit 12,000,000 lekë. Sot AKAFPK-ja ka realizuar aktivitetet e planifikuara sipas tabelës së mëposhtme:

***Tabela përmbledhëse e shpenzimeve të buxhetit të miratuar nga MMSR dhe realizuar nga AKAFPK sipas planit për vitin 2017***

Artikulli	600 Shpenzime për paga	601 Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	602 Shpenzime operative TOTAL	606 Fondi veçantë	231 Projekti “Skemat...”
Buxheti i <b>MIRATUAR</b> në Janar 2017 në lekë	15,892,000	2,654,000	23,000,000		2,102,000
Buxheti <b>PLAN</b>	15,892,000	2,654,000	23,000,000	73,257	2,102,000
Buxheti <b>FAKT</b>	13,193,996	2,043,778	9,257,714	73,257	2,043,004
Buxheti i <b>MBETUR</b>	2,698,004	610,222	13,742,286	0	58,996

Plani i buxhetit të AKAFPK-së dhe Realizimi i tij për vitin 2017



Mbështetur në tabelën e mësipërme, buxheti i AKAFPK-së, i planifikuar në artikullin 602 është shpenzuar në total në masën 40.25%. Gjatë vitit 2017, AKAFPK-ja ka vazhduar punën në zbatimin e projekteve të saj. Një nga projektet kryesore të saj është “Skemat e Çirakërisë për Punësimin e të Rinjve në Shqipëri”, projekt i Programit “ERASMUS + (Projekti. N. 556911-EPP-1-2014-1-AL-EPPKA3-APPREN,

marrëveshja N. 2014-3358 / 001-001, datë 02.12.2014. Data e përfundimit të tij 31.03.2017). Realizimet buxhetore të aktiviteteve të këtij projekti janë realizuar sipas tabelës së mësipërm.

9. Në kuadër të zbatimit të projektit “EPALE NSS in Albania” (Projekti “EPALE National Support Services”, Agreement number 20163042/001-001, Project Number 580174-EPP-1-2016-1-AL-EPPKA2-EPALE-NSS), AKAFPK-ja ka realizuar aktivitetet e planifikuara për vitin e parë të këtij projekti në shumat sipas tabelës së mëposhtme:

*Tabela përmbledhëse e shpenzimeve të buxhetit të projektit “EPALE National Support Services (NSS) for Albania 2017-18” në llogaritë Lek, realizuar nga AKAFPK sipas planit të këtij projekti për vitin e parë të tij, 2017.*

Llogaritë e Projektit	Buxheti i çelur në janar 2017	Buxheti i realizuar	Buxheti i mbetur
Llogaria në Lek	3247922	2699029	548893

10. Në mbështetje të Ligjit nr. 9936 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave “Për përgatitjen e Programit Buxhetor 2017 – 2019 sektorët e AKAFPK kanë bashkëpunuar në përgatitjen e tij.
11. Ndër prioritetet e Qeverisë Shqiptare, shprehur në Programin e Qeverisë si edhe në dokumentet e tjerë strategjikë si Udhërrëfyese për 5 (pesë) prioritetet e rekomanduara nga Komisioni Evropian apo “Strategjia Ndër-sektorialë e Reformës në Administratën Publike 2015 – 2020, është rritja e kapaciteteve të nëpunësve të administratës publike me synimin e krijimit të një administrate profesionale për t’i bërë ballë sfidave të zhvillimit në Shqipëri. Për sa më sipër, në zbatim të detyrimeve ligjore, AKAFPK kanë paraqitur nevojat për trajnim të stafit në fushat e parashtruara nga DAP në bashkëpunim me ASPA. Duke e konsideruar procesin e formimit profesional të nëpunësve si një proces thelbësor në formimin e Administratës të aftë profesionale, sektori i AF&TI i është përgjigjur kërkesave për trajnime nga MMSR dhe ASPA.
- Kështu, mbështetur në kërkesat e AKAFPK-së për trajnime në bazë të temave të planifikuara nga ASPA është trajnuar për vitin 2017 në sektorin e AFTI specialistja e financës mbi “Aksesimi ne sistemin HRMIS pwr borderotë online”.
12. Në mbështetje të Sektorit të Punësimit dhe Aftësive për periudhën 2016-2020 Qeveria shqiptare ka nënshkruar Marrëveshjen me Komisionin Evropian. Zbatimi i kësaj marrëveshjeje bazohet në arritjen e 10 indikatorëve. Një ndër këta indikatorë është kualifikimi nëpërmjet programit 24-ditor të trajnimit “Bazat e didaktikës në AFP” i të gjithë mësuesve dhe instruktorëve të shkollave të mesme profesionale dhe qendrave të formimit profesional. Brenda vitit 2017 jenë trajnuar nëpërmjet këtij programi rreth 308

mësues/instruktorë, nga të cilët kanë ndjekur dhe janë certifikuar nga programi i trajnimit, 252 mësues/instruktorë. mësues dhe instruktorë. që ushtrojnë profesionin e tyre pranë shkollave dhe qendrave të arsimit e formimit profesional. Procesi i këtij trajnimit u monitorua nga AKAFPK-ja, e cila ka ngritur grupin e punës. Përgjegjësi i sektorit të AFTI, si pjesë e grupit të punës është angazhuar gjatë vitit 2017 në monitorimin e disa prej trajnimeve të organizuara në Tiranë, Vlorë dhe Lezhë.

Si rezultat i punës së të gjithë stafit të AKAFPK-së, të cilët kanë dhënë kontributin e tyre individual apo në grup është bërë e mundur të kryhen me përgjegjësi dhe profesionalizëm detyrat në përputhje më objektivat e AKAFPK-së për vitin 2017.